


MARGARITARËT E NUMIZMATIKËS NGA KOLEKSIONET E MUZEVE TË KROACISË



Zlatko Dukat, Hermine Göricke Lukić, Tomislav Šeparović, Rimski medaljoni u hrvatskim muzejima-Roman medallions in Croatian Museums, Ministarstvo Kulture Republike Hrvatske, Muzej hrvatskih arheoloških spomenika-Split, Split 2004.

Gjatë vitit 2004 në Osijek (në muajin prill), Split (në korrik) dhe në Zagreb (në dhjetor) të Kroacisë u realizua një ekspozitë tejet interesante e unike, në të cilën ishin ekspozuar 34 medaljone romake, të gjetura në lokalitete të ndryshme të Kroacisë, si rezultat i bashkëpunimit të Muzeut Arkeologjik të Zagrebit (Arheološki Muzej u Zagrebu), Muzeut të Monumenteve Arkeologjike të

Kroacisë të Splitit (Muzej hrvatskih arheoloških spomenika u Splitu) dhe të Muzeut të Sllavonisë (Muzej Slavonije u Osijeku) e në organizim të autorëve Zlatko Dukat, Hermine Göricke Lukić dhe Tomislav Šeparović. Për këtë ekspozitë u botua një katalog reprezentues në dy gjuhë: kroate e angleze, me parathënie e me të dhëna, përshkrime e komente relevante përkatëse.

Nocioni medaljon rrjedh nga gjuha frënge (medaille, médaillon) dhe nënkupton vepër artistike në trajtë pllake të rumbullakët ose ovale prej metali me paraqitje figurale (në avers zakonisht portreti i perandorit dhe emri e titulli i tij perandorak dhe në revers figura të

perandorëve e të hyjnive të ndryshme) të punuara në relief. Medaljonet zakonisht ishin të punuara për nder të ndonjë perandori, të ndonjë personi të caktuar, të ndonjë ngjarjeje të jashtëzakonshme (triumfet e perandorëve nëpër luftëra) dhe përdoreshin si dekorata që u jepeshin ushtarakëve ose civilëve të merituar e, edhe si dhurata qytetarëve të rëndomtë në raste të caktuara.

Medaljonet ishin të dekoruara me portrete të perandorëve e perandoreshave dhe lidheshin me ngjarje të familjeve perandorake, siç janë: lindjet, martesat, vdekjet, ardhjet e shkuarjet e perandorëve e, po ashtu, ndaheshin me raste të kremteve fetare e të ngjarjeve të ndryshme solemne.

Me anë të medaljoneve glorifikoheshin trimëritë e perandorëve, kujtoheshin fitoret dhe sukseset ushtarake dhe madhështia e fuqia e shtetit romak. Për këtë arsye emetoheshin në sasi të limituara dhe gjetjet e tyre janë më të rralla në krahasim me monedhat. Janë të njohura disa lloje të medaljoneve.

Medaljonet prej bronzi dallojnë nga monedhat mbi të gjitha për nga diametri, pesha e trashësia e po ashtu edhe për nga mënyra më e sofistikuar e ekzekutimit të motiveve në relief të thellë. Medaljonet nga metalet fisnike, ndërkaq, kanë mund të futeshin në qarkullim të rregullt monetar dhe

kishin vlera më të mëdha në krahasim me monedhat e rëndomta. Në literaturën profesionale ata quhen *medaljone monetare*. *Medaljonet bimetalike* përbëheshin nga pjesa e brendshme, e punuar nga bakri, ndërsa pjesa rrethore punohej prej bronzi. Janë të njohura edhe të ashtuquajturat *pseudomedaljone*, që preheshin në kallëpe të njëjtë si monedhat, por dallonin nga ato për nga pesha e trashësia. Të tilla janë medaljonet e antikitetit të vonshëm prej bronzi, me paraqitje të perandorëve nga periudhat e mëhershme, të quajtur *kontorniatë*, përmes të cilëve glorifikoheshin ngjarjet e rëndësishme nga e kaluara e lavdishme si dhe besimet e lashta romake.

Edhe pse nuk kanë vlerë nominale e as valutore dhe janë emetuar me sasi të kufizuara, megjithatë medaljonet preheshin në punëtoritë monedhëprerëse të Romës e në ato provinciale, ashtu si edhe monedhat tjera, dhe hyjnë në kategori numizmatike.

Autorët e ekspozitës, përmes këtij katalogu, i kanë prezantuar 16 medaljone e 2 kontorniatë të përzgjedhura më reprezentative, më luksoze e më mirë të ruajtura prej bronzi, prej argjendi nga kolekcionet e muzeve arkeologjike të Zagrebit, Splitit e të Osijekut të Kroacisë.

Medaljonet në fjalë janë prezantuar si vijon:

1. Medaljon prej bronzi i perandorit Antonin Piu (Antoninus Pius, 138-161), i prerë mes viteve 145 dhe 161 me dimensione: 37 x 38 cm, dhe me peshë prej 33 gr. nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit.

Në avers të medaljonit është portreti i majtë i perandorit me kurorë dafine në kokë dhe rreth tij mbishkrimi: ANTONINVS PIVS PP PCOS TR P COS III IMP II (Antoninus Pius patër patriae proconsul tribunicia potestate consul III imperator II).

Në revers është një paraqitje mitologjike e një skene me Herakliun, i cili i vjedh mollët e arta të Junonës nga kopshti i Hesperidës.

2. Medaljon prej bronzi i perandoreshës Faustina Maior (Annia Galeria Faustina Maior, bashkëshortja e Antoninus Pius, 138-141), nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, me dimensione: 40 x 41 cm dhe me peshë 41,25 gr.

Në avers është portreti i djathtë i perandoreshës dhe rreth tij mbishkrimi: DIVA AVGVSTA FAVSTINA, ndërsa në revers është skena mitologjike e rrëmbimit të grave sabinase nga ana e romakëve dhe, nën këtë paraqitje, është shënimi SABINAE.

3. Medaljon prej bronzi i perandoreshës Faustina Minor (Annia Galeria Faustina Minor, bashkëshortja e Marcus Aurelius 161-175), nga koleksioni i Muzeut të monumenteve arkeologjike të

Splitit, me dimension 75 mm dhe me peshë prej 125 gr. Medaljoni është punuar nga pjesa e brendshme dhe nga pjesa rrethore. Në avers është portreti i majtë i perandoreshës dhe mbishkrimi rreth saj: FAVSTINA AVGVSTA, ndërsa në revers është figura e hyjneshës Fortuna, e ulur mbi fron me bri të bollukët në dorë dhe para saj djaloshi Triptolem, pa ndonjë mbishkrim në të. Ky medaljon mendohet që ka qenë i destinuar për dhurata me rastin e Vitit të Ri (strena).

4. Medaljon prej bronzi i perandorit Komod (Commodus, 180-192), i prerë në vitin 183, nga koleksioni i Muzeut të Sllavonisë në Osijek, me dimensione 37 x 38 mm dhe me peshë prej 50,01 gr.

Në avers është portreti i djathtë i perandorit me kurorë në kokë dhe rreth tij mbishkrimi: M AVR COMMODVS ANTONINVS AVGV (Marcus Aurelius Commodus Antoninus Augustus).

Në revers është paraqitja e figurës së perandorit në këmbë me pajisje luftarake, me heshtë në dorë dhe para këmbëve të tij dy robër lufte.

5. Medaljon i perandorit Septim Severi (Septimius Severus, 193-211), nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, i prerë mes viteve 196 dhe 197, prej bronzi, me dimension prej 40 mm dhe me peshë prej 49,95 gr.

Në avers është portreti i djathtë i perandorit me pajisje ushtarake dhe me kurorë dafine në kokë e

rreth tij mbishkrimi; L SEPTIMIVS SEVERVS PERTINAX AVG VII (Lucius Septimius Severus Pertinax Imperator VII).

Në revers është paraqitja e figurës së hyjit romak të luftës Mars, lakuriq, me heshtë dhe me mburojë në duar dhe rreth saj mbishkrimi: DIVI M PII F P M TR P IIII COS II PP (Divi Marci Pii Felici Ponifici Maximi tribunicia potestate IIII consul II patër patriae)

6. Një tjetër medaljon prej bronzi i perandorit Septimius Severus, i prerë pas vitit 207 nga koleksioni i Muzeu Arkeologjik të Zagrebit, me dimensione 38 x 40 mm dhe me peshë prej 49,35 gr.

Në avers është portreti i djathtë i perandorit me pajisje luftarake dhe me kurorë në kokë dhe rreth tij mbishkrimi: L SEPTIMIVS SEVERVS AVG IMP XII PART MAX (Lucius Septimius Severus Augustus imperator XII Particus Maximus). Në revers është paraqitja e perandorit dhe e hyjneshës, e cila personifikon qytetin e Romës dhe rreth tyre mbishkrimi: RESTITVTOR VRBIS (restaurues i famës së Romës).

Ky medaljon ishte emetuar me rastin e fitores së perandorit Septimius Severus kundër partëve, me çka u ishte kthyer fama e vjetër qytetit të Romës dhe Perandorisë Romake në përgjithësi.

7. Medaljon prej bronzi i perandorit Maksimini I^o (Maximinus I, 235-238), nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, me

dimensione 28 x 29 cm dhe me peshë prej 26,90 gr.

Në avers janë portretet e perandorëve Maksiminus dhe Maximus me pajisje luftarake dhe rreth tyre mbishkrimi: MAXIMINVS ET MAXIMVS AVGVSTI GERMANICI.

Në revers është paraqitja e figurave të dy perandorëve në këmbë me pajisje luftarake. Pas perandorëve janë figurat e dy ushtarëve në këmbë, ndërsa para këmbëve të tyre janë dy robër lufte e rreth figurave mbishkrimi: VICTORIA AVGVSTORVM, që simbolizonte fitoret ushtarake të këtyre dy perandorëve.

8. Medaljon prej bronzi i perandorit Gordiani III^o (Gordianus III^o, 238-244), nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, me dimension 29,5 cm dhe me peshë prej 28,35 gr.

Në avers është portreti i djathtë i perandorit me kurorë dafine në kokë, me pajisje luftarake dhe me heshtë në dorë dhe rreth tij mbishkrimi: IMP CAES M ANT GORDIANVS AVG (Imperator Caesar Marcus Antonius Gordianus Augustus).

Në revers janë figurat: e perandorit, i rrethuar nga komandanti i pretorianëve (gardës së truprojave të perandorit) dhe 4 ushtarë të tjerë e rreth tyre mbishkrimi: ADLOCVTIO AVGVSTI.

Adlocutio Augusti ishte fjalimi i perandorit para njësiteve të

rreshtuara, i cili simbolizonte afërsinë e perandorit me ushtri.

9. Medaljon prej argjendi i perandorit Gallieni (Gallienus, 253-268) nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, me dimensione: 36 x 39 cm dhe me peshë prej 28,46 gr.

Në avers është portreti i djathtë i perandorit me kurorë dafine në kokë dhe rreth tij mbishkrimi: IMP GALLIENVS P F AVG GERM (Imperator Gallienus Pontifex Maximus Augustus Germanicus).

Në revers është paraqitja e perandorëve Valerian e Gallien duke mbajtur fjalim para ushtarëve, ndërsa rreth tyre mbishkrimi: ADLOCVTIO AVGG (Adlocutio Augustorum).

Medaljoni është prerë gjatë kohës së sundimit të përbashkët të perandorëve Valerian e Gallien me rastin e fitoreve ushtarake kundër germanëve, në vitin 255 të erës sonë.

10. Medaljon prej argjendi i perandoreshës Salonina (Cornelia Salonina, bashkëshortja e perandorit Gallien, 260-268) nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, me dimensione 28 x 33 cm dhe me peshë prej 23,06 gr.

Në avers është portreti i djathtë i perandoreshës me diademë në kokë dhe rreth tij mbishkrimi: CORN SALONINA AVGVSTA (Cornelia Salonina Augusta).

Në revers është paraqitja e hyjneshës Pudicitia (hyjneshë e modestisë dhe e mirësjelljes) të

ulur në fron me heshtë në dorën e majtë e anash saj në këmbë Salus (hyjneshë romake e shëndetit fizik, e shpëtimit dhe e mirëqenies së shtetit romak) dhe Felicitas (hyjneshë e fatit dhe e lumturisë).

11. Një tjetër medaljon prej bronzi i perandoreshës Salonina nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, me dimension 39 mm dhe me peshë prej 49,50 gr.

Në avers është portreti i djathtë i perandoreshës me diademë në kokë e rreth tij mbishkrimi: CORNELIA SALONINA AVGVSTA. Në revers janë figurat e perandorit Galien dhe të Saloninës dhe rreth tyre mbishkrimi: CONCORDIA AVGVSTORVM, që do të thotë harmonia perandorake, e cila simbolizon dëshirën për stabilizimin e për përparimin e shtetit romak.

12. Medaljon prej bronzi i perandorit Probi (Probus, 276-282) nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, me dimensione: 30 x 33 mm dhe me peshë prej 20,05 gr.

Në avers është portreti i majtë i perandorit me pajisje luftarake, me kurorë dafine në kokë dhe me mburojë në dorë, ndërsa rreth tij mbishkrimi: IMP PROBVS PF AVG (Imperator Probus Pius Felix Augustus).

Në revers janë paraqitjet e tri figurave të Monetës (një nga emrat e kryehyjneshës romake Junona), secila me peshore në duar dhe mbishkrimi: MONETA AVG

(Moneta Augusta). Kjo paraqitje simbolizon rolin e perandorit mbi punëtoritë monedhëprerëse dhe mbi politikën monetare të shtetit në përgjithësi.

13. Një tjetër medaljon prej bronzi i perandorit Probi, nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, i prerë në vitin 281 e me dimensione 35 x 37 cm dhe peshë prej 25,6 gr.

Në avers është portreti i majtë i perandorit pajisje luftarake dhe me kurorë dafine në kokë, ndërsa rreth tij mbishkrimi: IMP C M AVR PROBVS PIVS AVG (Imperator Caesar Marcus Aurelius Probus Pius Augustus).

Në revers është paraqitja e perandorit mbi kalë me heshtë në dorë, duke e ndjekur armikun. Rreth figurës mbishkrimi: VIRT AVGVNOSTRI (Virtus Augu[s]ti nostri) e nën figurë shenja e punëtorisë monedhëprerëse: SIS (Siscia). Paraqitja e perandorit dhe mbishkrimi glorifikojnë figurën e perandorit gjatë luftërave kundër germanëve.

14. Medaljon prej bronzi i perandorëve Kari e Numeriani (Carus, Numerianus - 282-283) nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, me dimensione 35 x 37 cm e me peshë prej 29,7 gr.

Në avers janë portretet e perandorëve Kari e Numeriani, me kurora dafine në kokë dhe rreth tyre mbishkrimi: IMP CARO AVG [CARIN]O ET NVMERIANO (Imperatoribus Caro Augusti

Carino et Numeriano) dhe nën portretet: CAESS (Caesares).

Në revers janë figurat e perandorit Kar dhe të dy cezarëve (bijve të tij) duke kaluar pas hyjneshës se fitores Victoria dhe të pesë ushtarëve në prapavijë. Rreth figurave është mbishkrimi: ADVENTVS AVGG (Adventus Augustorum, që dmth: ardhja e perandorëve).

Medaljoni është prerë në vitin 282, me rastin e ardhjes në Romë të perandorit Carus e bijve të tij, pas rrëmbimit të fronit.

15. Medaljon prej bronzi i perandorëve Dioklecian e Maksimian (Diocletianus et Maximianus 286-305), nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, me dimensione 40x41 cm dhe me peshë prej 39,10 gr.

Në avers janë portretet e perandorëve Dioklecian dhe Maksimian me pajisje luftarake dhe me kurora dafine në kokë. Rreth portreteve është mbishkrimi: IMPP DIOCLETIANO ET MAXIMIANO AVGG (Imperatoris Diocletiano et Maximiano Augustorum).

Në revers figurat e Dioklecianit e Maximianit në këmbë, e pas secilit nga ta nga një figurë të hyjneshës Victoria, duke ua vendosur kurorat mbi koka dhe rreth tyre mbishkrimi: VICTORIAE AVGVSTORVM.

Medaljoni është prerë në vitin 293, me rastin e shënimit të përvjetorit të sundimit të Dioklecianit.

16. Medaljon prej bronzi i perandorit Konstandini II°

(Constantinus II°, 317, 337) nga koleksioni i Muzeut të Sllavonisë të Osijekut, me dimension 32 mm dhe me peshë prej 22,45 gr.

Në avers është portreti i djathtë i perandorit me kurorë të dafinës në kokë dhe rreth tij mbishkrimi: CONSTANTINVS IVN NOB C (Constantinus junior nobillissimus Caesar).

Në revers është paraqitja e anijes me 5 rrema, në hark të së cilës qëndron hyjnesha Victoria dhe rreth saj mbishkrimi: VICTORIA AVG (Victoria Augusta). Medaljoni është prerë në kohën e Konstandinit të Madh, derisa Konstandini II° kishte qenë Caesar (princ), me rastin e fitores së flotës së tij në Kalipoli.

17. Medaljon-kontorniat i antikitetit të vonshëm prej bronzi i perandorit Trajan (Traianus, 98-117) nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, me dimension 38 mm dhe me peshë 27,06 gr.

Në avers është portreti i djathtë i perandorit me kurorë dafine në kokë dhe rreth tij mbishkrimi: DIVO NERVAE TRAIANO.

Në revers është paraqitja e skenës mitologjike e Scilës duke i gëlltatur gjashtë marinare e Odiseut, ndërsa rreth saj nuk ka mbishkrim.

18. Medaljon-kontorniat prej bronzi i perandorit Konstans (Constans, 337, 337-350) nga koleksioni i Muzeut Arkeologjik të Zagrebit, me dimensione 34 x 35 cm dhe me peshë prej 22,37 gr.

Në avers është portreti i djathtë i perandorit me kurorë dafine në kokë e rreth tij është mbishkrimi: DN FL CONSTANS AVG (Dominus noster Flavius Constans Augustus). Në revers është paraqitja e perandorit mbi kalë duke e ndjekur armikun, ndërsa nën këmbët e kalit është një armik i vdekur. Rreth figurës është mbishkrimi: DEBELLATORI GENTT e nën figurë BARBARR. Duket se ky medaljon është prerë në fund të shekullit IV° me qëllim të ngritjes së moralit të ushtarëve.

Medaljonet e prezantuara në këtë katalog kronologjikisht përfshijnë periudhën nga gjysma e shekullit II° të erës sonë e deri në gjysmën e dytë të shekullit IV° të erës sonë dhe bie në sy fakti se në fillim, falë mirëqenies ekonomike të Perandorisë, medaljonet kishin pesha më të mëdha: 125 gr, 82 gr (Faustina Minor), ndërsa prej fundit të shekullit II° dhe fillimit të shekullit III° pesha e tyre bie në rreth 50 gr, në kohë të sundimit të perandorëve Komodi, Septim Severi, Salonina, 41,25 gr në kohën e perandoreshës Faustina Maior dhe, në 39,10 gr gjatë kohës së perandorëve Diokleciani e Maksimini, ndërsa nga fundi i shekullit III°, për shkak të krizave (ekonomike, ushtarake, sulmeve të barbarëve) që e kishin kapluar Perandorinë Romake, pesha e tyre bie dukshëm.

Vlen të përmendet fakti se një ndër gjetjet më reprezentative

numizmatike në Kosovë ishte medaljoni i rrallë i perandorit Probi (Probus, 276-282), i gjetur në Ulpianë, i plaçkitur në vitin 1998 nga ana e serbëve nga Muzeu i Kosovës në Prishtinë. Medaljoni është i punuar prej bronzi, me diametër 43 mm, me trashësi 5 mm dhe me peshë 42,15 gr. dhe është shumë mirë i ruajtur. Në avers të tij janë dy portrete: i perandorit Probi dhe i kryehyjit romak Jupiter, të kthyer majtas, me kurora dafine në kokë.

Në revers është paraqitja e perandorit në këmbë, i veshur me veshje ushtarake e mbi kalë, ndërsa pas tij është hyjnesha e fitores, Victoria, me krahë të hapur e me degë palme në dorë të majtë dhe me kurorë dafine në dorë të djathtë, me të cilën e kurorëzon perandorin. Para perandorit janë të vendosura armët e rrëmbyera nga armiku i mposhtur dhe dy gotë të zënë robër.

Medaljoni i Probit nga Ulpiana përmban skenat e deifikimit (hyjnizimit) të këtij perandori dhe triumfit të tij ushtarak mbi gotët, të vitit 278 të erës sonë, i punuar në relief të lartë dhe i prerë në punëtorinë monedhëprerëse në Siscia në Panoni (Sisaku i sotëm në Kroaci). Ekspozitat ku u prezantuan medaljonet, në Osijek, Split e Zagreb, ishin pritur jashtëzakonisht mirë nga publiku dhe patën jehonë edhe jashtë Kroacisë, duke pasur parasysh

faktin se medaljonet janë monumente me rëndësi të jashtëzakonshme, të cilat janë burim i dorës së parë për studimin e historisë, të numizmatikës dhe të besimeve romake të Kroacisë dhe jo vetëm gjatë epokës së Perandorisë Romake.

Prof. Dr. Naser FERRI